

VENDIM
Nr. 625, datë 21.12.1999

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROJEKTIT “RAPORT KOMBËTAR I
ZHVILLIMIT NJERËZOR 1999” TË FINANCUAR NGA UNDP

Në mbështetje të nenit të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1992, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin, në parim, të projektit “Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor 1999” të financuar nga UNDP-ja, në shumën grand prej 41 000 dollarë.

2.Ngarkohet Instituti i Statistikës të ndjek zbatimin e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta